



KOMUNA E GJAKOVËS

kk.rks-gov.net/gjakove | 0800 60000; 0800 60001
Rr./Str: Nëna Terezë | Gjakova; KOSOVA 50000

POTENCIALET EKONOMIKE TE KOMUNËS SË GJAKOVËS

THE ECONOMIC POTENTIAL OF THE MUNICIPALITY OF GJAKOVA



ALB | ENG

POTENCIALET EKONOMIKE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS
THE ECONOMIC POTENTIAL OF THE MUNICIPALITY OF GJAKOVA

PROFILI I KOMUNËS
PROFILE OF THE MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA

Qyteti i Gjakovës është zhvilluar gjatë shek. XIV- XV, rreth Xhamisë së Hadumit, e ndërtuar në shekullin XVI dhe ka një qendër të zhvilluar tregtare dhe zejtare. Qendër kulturore dhe arsimore, me bibliotekë të pasur dorëshkrime dhe libra të ndryshëm, Çarshinë e Madhe të ndërtuar nga mjeshtrit e parë dhe nga puna zejtare e tyre. Gjatë shek. XV dhe XVI, ekonomia e Gjakovës u zhvillua rreth Çarshisë së Madhe. Çarshia e Madhe është karakteristika më e veçantë e Gjakovës. Me një strukturë orientale me rrugë të përdredhura, e cila lidh lagjet e ndryshme, ajo frymëzon çdo arkitekt. Nga prespektiva e arkitekturës, kjo çarshi paraqet një strukturë interesante e njohur me modelet më të bukura të arkitekturës tradicionale dhe aftësive të mira të ndërtimit duke filluar nga detajet më të vogla e deri tek komplekset më të mëdha të ndërtesave, objekteve, mjediseve dhe urbanizmit, duke e bërë Çarshinë e Madhe simbol tradicional të Gjakovës. Gjakova gjithmonë ka pasur një ekonomi të zhvilluar dhe ka qenë gjithmonë qytet me karakter ekonomik dhe industrail . Komuna e Gjakovës sot ka potenciale ekonomike në: prodhim, ndërtim, shërbim, tregti, hotelieri, artizanate, ndërmarrje transporti dhe kompani të teknologjisë informative.

The city of Gjakova was developed during the XIV-XV centuries, around the Hadumi Mosque which was built on the XVI century, and it has been a center of commerce and craftsmanship. A cultural and educational center, with a library voluminous of books and manuscripts, and the Big Bazaar (Çarshia e Madhe) built from the first and finest craftsmen of the time. During the XV-XVI centuries, the economy of Gjakova was built around the Big Bazaar, which is the most distinctive characteristic of Gjakova. With an oriental structure, and roads which connected different neighborhoods of the city, it was an inspiration for the architects. From the architectural standpoint, the Big Bazaar presents an interesting structure, well known for its beautiful, traditional architecture and good craftsmanship, starting from the smallest of details to the complexity of the big buildings, environment, and the urbanism, thus making the Big Bazaar a traditional symbol of the city. Gjakova has always had a well-developed economy and it has always been a city of economic and industrial character. Today, the municipality of Gjakova has an economic potential in: Production, Construction, Services, Commerce, Tourism, Handicraft, Transportation, and IT.

PËRSHKRIM EKONOMIK
ECONOMIC DESCRIPTION

Valuta: EURO (€)
Currency: Euro

Sektori financiar: Sistem bankar me dy nivele, i përbërë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe 10 banka komerciale.
Bizneset dhe Ndërmarrjet: Mbi 3500 NVM aktive, rreth 38 % të të gjitha NVM-ve përfshihen në industrinë e tregtisë, 16% Industria përpunuese, etj.
Sistemi i taksave: TVSH 8% dhe 18 %, Tatimi në fitim i korporatës 10%, taksa progresive e të ardhurave personale 10 %.
Tregtimi i lirë: Për qasje pa dogana në tregun e BE-së në bazë të Regjimit të Preferencës për Tregti Autonome të BE-së , Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore - CEFTA dhe trajtimit preferencial të mallrave të eksportuara në tregun e jashtëm.
Faktorët e lokacionit: Fuqi punëtore e re, konkurruese dhe e arsimuar mirë, burime të lakmueshme natyrore (minerare, bujqësore), taksa të ulëta dhe sistem transparent taksash.

The financial sector: The banking system of two levels, consisting of Kosova Central Bank (BQK) and ten (10) commercial banks.
Business and Entrepreneurship: Over 3500 active SME-s, with over 38% of all the SME-s in the commerce industry, 16% in manufacturing etc.
Tax System: VAT 8% and 18%, Profit Tax on Corporations of 10%, progressive tax on personal income of 10%.
Free Market: For free access in the EU market through the Regjimi i Preferencës për Tregti autonome, Central European Free Trade Agreement (CEFTA), and the preferential treatment for exporting products.
The Location Factors: A very young, competitive, and well-educated work-force, lots of natural resources (minerals, agricultural), low taxes and a very transparent taxing system.

GJEOGRAFIA DHE KLIMA

GEOGRAPHY AND CLIMATE

- ◆ Sipërfaqja: 556,84 km²
- ◆ Pyje: 26,264 hektarë
- ◆ Klima: Klimë e mesme kontinentale
- ◆ Zona kohore: CET (UTC+1)
- ◆ Kodi postar :50,000
- ◆ Kodi i zonës: +383 390

- ◆ Area: 55,684 km²
- ◆ Wooded area: 26, 264 hectares.
- ◆ Climate: Moderate Continental Climate
- ◆ Time Zone: CET (UTC+1)
- ◆ Postal Code: 50,000
- ◆ Zonal Code: +383 390

Popullsia		
	Banorë	%
Popullsia	94.556	
- Urbane	40.827	43%
- Rurale	53.729	57%
Population:		
	Residents	%
Population:	94.556	
- Urban	40.827	43%
- Rural	53.729	57%

TRANSPORTI

TRANSPORTATION

Komuna e Gjakovës kufizohet me Republikën e Shqipërisë, me dy pikat e kalimit kufitar; Qafa e Prushit në jug - që lidh Gjakovën me rajonin e Hasit dhe Qafa e Morinës në perëndim - e cila lidh Malësinë e Gjakovës. Kjo lidhje nuk është vetëm infrastruktura bazë e rrugëve, por është arterie shumë e rëndësishme që shkon nga Shkodra, Kukësi, Tropoja, Puka, Mirdita, dhe vazhdon në zona të tjera të Shqipërisë veriore, me të cilat historikisht Gjakova kanë pasur marrëdhënie të forta historike, kulturore dhe ekonomike.

The municipality of Gjakova is in the border with the Republic of Albania, with two crossing points: Qafa e Prushit in South – which links Gjakova with the Region of Has, and Qafa e Morines in the West – which links it with Malesia e Gjakoves. Those links are not only a basic road infrastructure, but it is a very important artery that goes from Skodra, Kukesi, Tropoja, Puka, Mirdita, and continues to the other zones of North Albania, with whom Gjakova has historically had strong relationships, both cultural and economic.

DISTANCAT NGA QYTETET KRYESORE EVROPIANE

SHKUP	138
TIRANË	208
SOFIA	366
SELANIKU (PORTI)	372
BEOGRAD	397
SARAJEVË	355
ZAGREB	785
BUDAPEST	770
LUBLANË	887

DISTANCE FROM THE MAIN EUROPEAN CITIES:

SKOPJE	138
TIRANA	208
SOFIA	366
THESSALONIKI (PORT)	372
BELGRADE	397
SARAJEVO	355
ZAGREB	785
BUDAPEST	770
LJUBLJANA	887

Komuna e Gjakovës kufizohet me komunat e Prizrenit, Rahovecit, Klinës, Pejës, Deçanit dhe Junikut. Hekurudha gjithashtu kalon në afërsi – në fshatin Xërxë rreth 13 km nga qyteti, dhe Kramovik gati 9 km. Katër rrugë rajonale lidhin Gjakovën me qytetet dhe fshatrat e tjera në perëndim të Kosovës. Autostrada me 4 korsi në drejtim të Prizrenit dhe në drejtim të Prishtinës është në ndërtim e sipër.

The municipality of Gjakova is in between the municipalities of Prizren, Rahovec, Klina, Peja, Deçan, and Junik. There is a railway nearby – in Xërxë village, 13 km from the city, and Kramovik, 9 km from the city. Four regional roads connect Gjakova with the other cities and villages in the West of Kosovo. While the highway to the cities of Prizren and the capital city of Pristina in being construction process.

AEROPORTI I GJAKOVËS

Aeroporti i Gjakovës gjendet rreth 5 km në veri të qytetit të Gjakovës. Është i vendosur në një hapësirë relativisht të rrafshët rreth 400m mbi nivelin e detit. Pista është 1,799 metra e gjatë, 30 metra e gjerë dhe e orientuar në drejtimet 17-35. Sipërfaqja e pistës është asfalt, anët e pistës janë të gjëra 7.5 metra të përbëra nga zhavori. Hapësira e terminalit të aeroportit përbëhet nga hapësirat e terminalit të udhëtarëve dhe mallrave, parkingu i aeroplanëve, hapësirat për ngarkimin, shkarkimin dhe hapësirat për shërbime të udhëtarëve. Aeroporti i Gjakovës ka në dispozicion sistemin për aterrim instrumental dhe sistemin navigues NDB (Non-directional Beacon) që përdoret si ndihmë për navigim nga ana e pilotëve, poashtu është e instaluar një kullë mobile e kontrollit të trafikut ajror, plotësisht e pajisur me sistemet e nevojshme të komunikimit tokë-ajër. Aeroporti ka edhe infrastrukturën e furnizimit me rrymë dhe ujë ,dhe po ashtu ekziston sistemi i ndriçimit aeronautik në tokë dhe i ndihmesave vizuale dhe atyre të radio-navigimit. Po ashtu, në këtë aeroport ekziston edhe infrastruktura dhe mjetet për shërbimin e shpëtimit, zjarrfikjes dhe për furnizimin me karburante të aeroplanëve. Në vitin 2019 Aeroporti i Gjakovës, me vendim të Qeverisë së Kosovës, i është dorëzuar Ministrisë së Mbrojtjes, e cila edhe tani e ka në shfrytëzim në kohë të pacaktuar për nevojat strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës

GJAKOVA AIRPORT

The airport of Gjakova is located 5 km in the north of the city of Gjakova. It lies in a relatively flat zone, around 400m over the sea level. The runway is 1,799 meters long, 30 meters wide, and oriented in 17-35 directions. The surface of the runway is asphalt, and its sides as 7.5 meters wide, made from gravel. The terminal of the airport is made of the passengers and commodities site, airplane parking site, shipment sites, and the passenger service site. The airport of Gjakova has the system for instrumental landing and the NDB (Non-directional Beacon) navigation system, which is used as assistance for navigation from the pilots. There's also an airport navigation tower, fully equipped with ground-air systems of communication. The airport has also the necessary infrastructure of water and electricity supply, and there's also the system of aeronautical lighting in the ground, the visual helping and the radio navigation tools. The airport also has the necessary infrastructure and the tools for rescue, fire-fighting, and supplying the airplanes with fuel. In 2019, the Kosovo Government ruled to give the airport to the Ministry of the Defense, which now has the right to utilize it for strategic needs of the Ministry of Defense and the KSF (Kosovo Security Force).



THEMELIMI I KOMPANISË


Zyra e biznesit në kuadër të komunës ofron shërbime për:

- Regjistrimin e bizneseve të reja
- Regjistrimin e ndryshimeve në biznes
- Kërkesat për mbylljen e biznesit

Aplikimi bëhet në zyrën komunale të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës ARBK. Formularët për aplikim janë të ndryshëm në varësi të llojit të biznesit që qytetarët janë gatshëm për t'u regjistruar; zakonisht aplikohen për bizneset individuale (BI), Kompani me Përgjegjësi të Kufizuar (KPK), dhe Shoqëri Aksionare (ShA). Procedura e regjistrimit të biznesit është e lehtë dhe ajo bëhet brenda një periudhe të shkurtë kohore. Investitorët e huaj mund të zgjedhin në mes të disa llojeve të bashkëpunimit dhe partneriteteve për zhvillimin e biznesit në Komunën e Gjakovës.

Kategoritë e organizimit të biznesit të përcaktuara me ligj janë:

- Biznes individual
- Partneritet i përgjithshëm,
- Partneritet,
- Kompani me Përgjegjësi të Kufizuar (KPK),
- Kompanitë aksionare (Sh.A)
- Kompani e huaj,
- Ndërmarrjet shoqërore,
- Ndërmarrjet publike,
- Kooperativat bujqësore



OPENING A BUSINESS

The business office that operates in the Municipality of Gjakova offers those services:

- Registration of new businesses
- Registration of change in a business
- Request for the closure of a business


The application is made in the Business Registration Agency (ARBK) office within the municipality of Gjakova. The application forms depend on the type of business that the citizens are requesting to register; usually they apply for Individual Business (BI), Limited Liability Company (LLC), and Joint-Stock Company (ShA). The registration process is easy and fast. Foreign Investors can choose between different types of cooperation and consortiums to make business in the Municipality of Gjakova.

The business categories, as specified by law are:

- Individual Business
- General Partnership
 - Partnership
- Limited Liability Company
- Joint-Stock Company
 - Foreign Company
 - Social Enterprise
 - Public Enterprise
- Agricultural Cooperatives

BIZNESET, NDËRMARRJET DHE AMBIENTI I BIZNESIT


Raport i cili bazohet nga të dhënat zyrtare të Administratës Tatimore të Kosovës i cili edhe përputhet me numrin e Bizneseve deklaruese dhe jo deklaruese në Komunën e Gjakovës është 4,475 Biznese AKTIVE, prej të cilave 3,486 Biznese deklaruse dhe 989 biznese jo deklaruese. Numri i punëtorve në sektorin privat është 8506.



Numri i bizneseve të regjistruara në sektorin privat, tregtia me shumicë dhe pakicë përbënte 38% të totalit, ndërsa industria prodhuese dhe përpunuese me vetëm 16%. Sektorët tjerë më të zhvilluar sipas këtij klasifikimi janë: hoteleria dhe akomodimi me 11%, shërbimet me 8%, dhe ndërtimtaria me 6%

BUSINESSES, ENTERPRISES, AND THE BUSINESS ENVIRONMENT

A report based on official data from the Kosovo Tax Administration (ATK) shows that there are 4,475 active businesses in the Municipality of Gjakova, from which 3,486 are VAT declaring businesses, and 989 nondeclaring. The number of employees in the privat sector in Gjakova is 8506.



The number of registered businesses in the private sector, wholesale and retail constituted 38% of the total, while the processing and manufacturing industry only 16%. Other most developed sectors according to this classification are: hospitality and accommodation with 11%, services with 8%, and construction with 6%.

TATIMET NË KOSOVË

Përgjegjësi e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) është që të administrojë zbatueshmërinë e çdo lloji të tatimit të aplikuar me legjislacionin tatimor në Republikën e Kosovës. Ndryshe nga shumë vende të tjera në rajon, Kosova ka vënë një sistem taksimi të thjeshtë dhe që redukton barrën e taksave për individët dhe bizneset.

ATK, është përgjegjëse për inkasimin e tatimeve qendrore qeveritare ku bëjnë pjesë:

- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) në furnizimet e brendshme;
- Tatimi në të Ardhurat Personale;
- Tatimi në të Ardhurat e Korporatave;
- Tatimet e mbajtura në burim;
- Kontributet Pensionale;

TATIMI NË PRONË

Kuvendi Komunal i çdo komune përcakton normat tatimore mbi pronën në bazë vjetore.

- Pronë Rezidenciale
- Pronë Komerciale
- Pronë Industriale
- Pronë Bujqësore
- Pronë e patundshme braktisur dhe ndërtesa të pa banuara .

MARRJA E PARCELËS, DISPONUESHMËRIA, PROMOVIMI DHE INVESTIMI

Toka në Komunën e Gjakovës është kategorizuar si tokë bujqësore ose ndërtimore. Toka në pronësi publike për ndërtim mund të ipet në shfrytëzim për zhvillimin ekonomik, vetëm me vendim të Komunës së Gjakovës dhe / ose Ministria e Mjedisit, ose procedurat e privatizimit. Informacione mbi ndonjë parcelë të veçantë dhe / ose zotimet ekzistuese mund të merren nga Komuna e Gjakovës, ku prona është regjistruar në regjistrin komunal dhe mund të merret duke kontaktuar Agjencinë për Promovimin e Investimeve të Kosovës.

TAXES IN KOSOVO

It's Kosovo Tax Administration's (ATK) responsibility to administer the applicability of every applied form of taxation with the tax legislation of the Republic of Kosovo. In contrast to many countries in the region, Kosovo has a simple tax legislation to reduce the tax burden for the individuals and businesses.

Kosovo Tax Administration (ATK) is responsible for the collection of central governmental taxes which include:

- Value Added Tax (VAT) on internal supplies;
- Personal Income Tax;
- Corporate Income Tax;
- Withholding tax;
- Pension Contribution

PROPERTY TAX

Municipal Assembly of each municipality establishes taxing norms on the property on annual basis.

- Residential Property
- Commercial Property
- Industrial Property
- Agricultural Property
- Abandoned Real Estate

LAND USE, AVAILABILITY, PROMOTION, AND INVESTMENT


The land in the municipality of Gjakova is categorized as agricultural or constructional land. The land with public ownership, can be given for construction purposes with the intention of economic development, only by and order from the Municipality of Gjakova and/or The Ministry of Environment of the Republic of Kosovo, or by privatization procedures. Information on any specific piece of land can be obtained from the Municipality of Gjakova, where the land is registered on the municipal registry and can be obtained by contacting the Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA).

ENERGJIA DHE MINIERAT

ENERGY AND MINING

Gjakova ka potencial për të investuar në sektorin e energjisë. Në nivel të Kosovës, Gjakova ka temperaturat më të larta, 278 ditë në vit është nën rrezet e diellit. Ofron kushte atmosferike pa mjegull dhe dukshmëri të theksuar. Komuna e Gjakovës posedon edhe Toka jobujqësore prej 40%, të cilat mund të përdoren për potencial të Investimeve në sektorin e Prodhimit të Energjisë. Komuna e Gjakovës është e pasur dhe me krom (Cr). Miniera Deva është e njohur për mineralet burime të kromit në Kosovë, përfshirë burimet e tjera në fshatrat: Babaj Bokës, Ponoshec, Popovc, Qafë Prush etj. Duke pasur parasysh koston e ulët të fuqisë punëtore dhe karakteristikat e ngjashme të cilat janë të një rëndësie të veçantë për zhvillimin e parqeve të erës, pra rrugëve dhe transmetimit të energjisë elektrike që janë shumë afër vendit të propozuar ku burimet e erës konsiderohen të disponueshme, Komuna e Gjakovës mbetet e hapur dhe inkurajon të gjithë investitorët për këtë mundësi.

Gjakova has a potential for investing in the energy sector. Gjakova has the highest temperature in national level, and 278 days a year is under the rays of sun. It offers atmospheric conditions fog-free and with high visibility. The Municipality of Gjakova also possesses non-agricultural land with 40% of the total, which can be used for potential investment in the energy production sector. The municipality of Gjakova is also rich with Chromium (CR). Deva Mines is famous in Kosovo for minerals with Chromium resources, including other villages as: Babaj i Bokes, Ponoshec, Popovc, Qafë Prush, etc. Bearing in mind the low cost of the labor force, and similar characteristics which are of special importance for the development of wind parks, like roads and the transmission of the electricity which are very close to the proposed places where the wind resources are available, the Municipality of Gjakova is open and encourages everyone for this opportunity.



Ndërmarrja “Jatex” dhe “Emin Duraku” kanë qenë shumë aktive dhe të rëndësishme për ekonominë në rajon, duke ofruar njësi prodhimi dhe shërbimi për të gjitha pjesët e industrisë së tekstile. Këto ndërmarrje ishin gjithashtu eksportues të rëndësishëm për disa vende evropiane. Sipas statistikave të fundit egziston një numer i konsiderueshëm i biznese aktive në rajonin e Gjakovës që i përkasin industrisë së tekstit; dmth: prodhimi i ndërresave, uniformave, industria e lëkurës etj. Sektori i tekstitit kërkon një stimulim pozitiv që ta rrisë ndikimin në ekonominë e Gjakovës dhe kështu, të jetë në gjendje të depërtojë në tregun evropian. Këtu janë disa nga kompanitë të cilat merren me prodhimtari ne inmdustrine e tekstitit në Gjakovë:

“Jatex” company and “Emin Duraku” were very active and very important for the economy in the region, offering production and service units for every part of the textile industry. Those companies were very important exporters for some European countries. According to the latest statistics, there is a considerable amount of active businesses in the Gjakova region that operate in the textile industry – kit production, uniforms, leather industry etc. Textile industry requires a positive stimulus to increase its impact on the Gjakova economy, and thus being able to operate in the European market. Here are some of the companies that operate in the textile industry in the Municipality of Gjakova:

TEKSTILI

TEXTILE



BUJQËSIA
AGRICULTURE

Bujqësia është burimi kryesor i të ardhurave për 70 % të popullsisë rurale. Në total janë 55.684 ha tokë, 29.445 ha nga të cilat janë në pronësi publike dhe 26.239 ha në pronësi private. Zona e pyjeve në total është 26.264 ha, nga të cilat 17.435 ha i përkasin sektorit publik. Objektivat e zhvillimit të bujqësisë në Komunën e Gjakovës janë në harmoni me objektivat dhe strategjinë zhvillimore të rajonit dhe të BE-së: Edukimi i vazhdueshëm , përcjellja e inovacioneve në sektorin e bujqësisë, forcimi i zingjirit ushqimor, mbrojtja e kafshëve dhe menaxhimi i rrezikut në bujqësi, mbështetja institucionale në riaktivizimin e fermave, plantacioneve bujqësore dhe kapaciteteve përpunuese ushqimore, përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe rritje të sipërfaqeve punuese me sistem të ujitjes në funksion të rritjes së rendimentit.

Agriculture is the main resource of income for 70% of the rural population. In total, there are 55.684 ha of land, from which 29.445ha are on public ownership while 26.239ha are private properties. Wooden are in total is 26.264ha from which 17.435 is public property. The objectives of agricultural development in the Municipality of Gjakova are in harmony with the objectives and the development strategy of the region and the EU: Continual education, application of innovations in the agricultural sector, strengthening of the food chain, animal protection agricultural risk management, institutional support on reactivating farms, agricultural plantations and food processing capacities, improvements in the irrigation process, and increasing working surface with an irrigation system to increase yields.

POZITA E SEKTORIT TË BUJQËSISË | THE POSITION OF THE AGRICULTURE SECTION

LLOJI I BUJQËSISË AGRICULTURE TYPE	TOTAL (HA) TOTAL(HA)
KOPSHTE FUSHASH GARDEN FIELD	14.995
FRUTA FRUITS	480
VRESHTA VINEYARDS	75
BAR GRASS	7.154
LIVADHE MEADOW	6.716
MALE MOUNTAIN	26.264
GJITHSEJ TOTAL	55.684


KULTURA CROP	KULTIVOHEN (Ha) CULTIVATED (Ha)	FITOHEN (kg/ha) YIELDS (kg/ha)
GRURË WHEAR	4.500 - 5.000	3.500 - 4.000
MISËR CORN	3.500 - 4.600	5.000 - 8.000
PERIME VEGETABLES	900 - 1.000	15.000 - 20.000
FRUTA FRUITS	40 - 500	

TURIZMI
TOURISM

Qyteti i Gjakovës është i njohur si qendër kulturore, jo vetëm në nivel komunal, por edhe brenda rajonit dhe vendit. Monumentet e shumta historike të mbrojtura me ligj si: Ura e Tabakëve, Ura e Terzive, Ura e Taliqit, kulla të ndryshme në qytet dhe zona rurale, Sahat Kulla, muzeu, ndërtesat e banimit, vendbanimet urbane -Çarshija e Madhe, xhamitë, kishat, vendet arkeologjike, teqetë, etj. Gjakova është e pasur me burimet e ujit p.sh. lumi Ereniku, Drini i Bardhë, Lumi Krena e liqeni i Radoniqit. Duke pasur parasysh se Gjakova me rrethinat e saj është një nga qendrat me mundësi më të mëdha për zhvillim ekonomik , bazuar në potencialin dhe burimet e disponueshme për zhvillimin e turizmit. Natyra mbresëlënëse e pashkatërruar do të jetë tërheqëse edhe për qytetarët dhe vizitorët e shumtë. Gjate viteve te fundit Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka bërë investime kapitale në disa projekte të cilat janë te lidhur me fushën e turizmit, projekte këto që do të ndikojnë në rritjen e vizitorëve në Komunën tonë e cila orientohet në zhvillim ekonomik te qëndrueshëm. Këto projekte siç janë: Shpella Kusarit, Ura Terzive, Ura Tabakut, Kanioni Drinit & Ura e Fshajit, etj., po japin rezultat sepse sot kemi një numër të madh të vizitorëve vendor dhe ndërkombëtar. Më poshtë gjeni informatat të strukturuar në diagram të ndara sipas përqindjes ku vërehet se numri më i madh i vizitorëve vijnë nga Shqipëria, Gjermania, Zvicra, etj.

The city of Gjakova is known as a cultural center not only in a municipal level, but also in the country and in the region. Numerous historical monuments protected by law like: Ura e Tabakve (bridge), Ura e Terzive (bridge), Ura e Taliqit (bridge), different towers in the city and in rural areas, Watch Tower, the museum, residential buildings, urban residencies – Big Bazaar, mosques, churches, archeological sites, etcr. Gjakova is also rich with water springs like: Erenik river, White Drini, Krena River, and Radoniqi lake. Gjakova with its suburbs is one of the regions with highest opportunities for economic growth, based on the potential and the available resources for the development of tourism. It’s impressive, undestroyed nature will be very attractive for the expected visitors. In recent years, the Department for Economic Development has made capital investments in some projects related to the tourism sector that will result in an increase of visitors in our municipality. Those projects that include: Kusari’s Cave, Ura e Terzive, Ura e Tabakut, Drini Canyon, Ura e Fshajit etc, have resulted in an increase in the number of both local and international visitors. Below you will find information structured in diagrams and separated based on the percentage where you can see that the highest number of visitors come from Albani, Germany, Switzerland etc.

NUMRI I TURISTËVE I SHPREHUR NË PËRQINDJE
NUMBER OF TOURISTS EXPRESSED IN PERCENTAGE



PARAQITJA TABELORE E NJËSIVE AKOMODUESE PËR VITIN 2019
TABULAR PRESENTATION OF ACCOMMODATION UNITS FOR 2019

Njësitë akomoduese Accommodation Sites	Numri dhomave Number of Rooms	Numri shtreterve Number of Beds	Mesatarja netë qëndrimi Average of Night Stayed	Numri për njësi Number of Unit	Totali netë qëndrimi Total Staying Nights
19	228	546	2.5	5183	18215



TEKNOLOGJIA INFORMATIVE DHE E KOMUNIKIMIT (TIK)

Sektori TIK në Kosovë ka përjetuar një zhvillim të jashtëzakonshëm në dekadën e fundit. Ky sektor sot ofron shërbime me cilësi të lartë dhe teknologjinë më të fundit për konsumatorët në Kosovë, si dhe shërbime të jashtme për kompanitë e huaja jashtë vendit. Qyteti i Gjakovës ka 60% të të rinjve të arsimuar nën moshën 30. Një numër i konsideruar i tyre tashmë janë duke punuar në tregun e TIK si përkthyes të pavarur dhe programues në kompani serioze të TIK-ut në Gjakovë, Prishtinë dhe jashtë vendit. Kompanitë vendore ofrojnë shërbime me cilësi të lartë me kosto të ulët, duke përfshirë zhvillimin e software-it, shërbimet e konsulencës, si dhe menaxhimin e të dhënave. Kosova ka dy operatorë celularë virtualë Vala dhe IPKO. Përveç kësaj, mundësi të mëdha për investitorët e huaj janë në dispozicion për telefoninë fikse, VoIP, TV kabllor, etj. Gjakova ofron mundësi të mëdha në fushën TIK duke zhvilluar gjeneratën e ardhshme të platformave të hapura me një diversitet të pajisjeve të reja, aplikimet dhe sistemet mund të aplikohen.

Mundësitë kryesore në tregun e TIK:

- Disponueshmëri e profesionistëve të mirëarsimuar, të diplomuar jashtë vendit.
- Infrastrukturë celulare dhe internet me zhvillim të shpejtë.
- Niveli i mirë i bashkëpunimit në mes kompanive dhe universiteteve.
- Të rinjtë janë të etur për të mësuar, për t'u trajnuar dhe për t'u certifikuar për programet ndërkombëtare

INFORMATION AND COMMUNICATIONS TECHNOLOGY

The Information and Communications Technology (ICT) sector in Kosovo has had a significant development in the last decade. Today, this sector offers high quality services, and the latest technology for its costumers in Kosovo, as well as outside services for foreign companies. The city of Gjakova has 60% education rate among the youth under 30 years old. A considerable number of those are already working in the ICT sector in Kosovo as independent translators, and programmers in ICT companies throughout Gjakova, Pristina, and also abroad. Local companies offer high quality and low-price services, including software development, consulting services, and data management. Kosovo has two virtual cellular operators, Vala and IPKO. Apart from that, there's also VoIP, Cable Tv etc. Gjakova offers big opportunities in the ICT sector, while developing the next generation of open platforms with a diversity of new technology.

Biggest opportunities in the ICT sector include:

- The presence of well-educated professionals that have graduated abroad.
- Cellular infrastructure and high-speed developing internet.
- A good level of cooperation between universities and companies.
- A youth eager to learn, train, and get certified for international programs

ZONA EKONOMIKE AMERIKANE

Në vitin 2018 në Komunën e Gjakovës është themeluar Parku Industrial në Gjakovë, "Zona Ekonomike Amerikane". Qeveria e Kosovës ka miratuar kërkesën dhe ka ndarë buxhet për ndërtimin e Infrastrukturës, meqë Komuna ka ofruar tokën me sipërfaqe 486.6655 HA, e shtrirë në magjistralen Gjakovë - Prishtinë. Kjo zonë, përveç që ka pozitë të mirë gjeografike, do të ketë edhe ndikim shumë të madh në zhvillimin Ekonomik të Gjakovës e cila ka për synim tërheqjen e investitorëve dhe bizneseve Amerikane më qëllim të plasimit të produkteve apo shërbimeve të tyre në tregun Evropian. Zona ekonomike Amerikane do të sigurojë infrastrukturë më të mirë për bizneset e vendosura brenda zonave ekonomike, do të krijojë kushte afarizmi për qasje më të lehtë në furnizimin me:

- Energji elektrike
- Rrjetin e ujit,
- Rrjetin e gazit,
- Qasjen në infrastrukturën rrugore ,
- Trajtimin e ujërave të zeza dhe
- Mirëmbajtjen e zonave publike– menaxhimin e mbeturinave.

AMERICAN ECONOMIC ZONE

In 2018, the Industrial Park called "The American Economic Zone" was established in the Municipality of Gjakova. The Government of Kosovo, approved the request and allocated a budget for the construction of the infrastructure, while the Municipality has offered the land with an area of 486.6655ha, located in the Gjakova - Prishtina highway. This zone, is not only located in a good geographical position, it will have a high impact in the economic development of the Municipality of Gjakova, which aims to attract American businesses and investors, with the purpose of placing their products and/or services in the European market. The American Economic Zone will ensure a better infrastructure for the businesses located in the within the economic zones, will offer a better business climate and an easier access to:

- Electricity
- Water Supply
- Gas Network
- Access to Road Infrastructure
- Sewer Treatment and
- Public Zone Maintenance – Waste Management



QENDRA PËR AFTËSIM PROFESIONAL (QAP) PROFESSIONAL TRAINING CENTER (QAP)



Në këtë qendër bëhet aftësimi dhe ri-aftësimi i personave që janë të regjistruar si punëkërkuar, të papunë dhe ata që marrin shërbime për orientim në karrierë, pranë të gjitha zyrave të punësimit.

Aftësimi profesional bazohet në dy objektiva : (i) Trajnimi institucional në Qendrat e Aftësimit Profesional dhe (ii) Trajnimi i kombinuar (QAP dhe kompani).

Qendrat për Aftësim profesionale (QAP) ofrojnë trajnime për të papunët dhe punëkërkuar për një profesion të caktuar falas duke u fokusuar në aplikimin e shkathtësive dhe njohurive praktike duke përdorur mësimin në kabinete të ndryshme.

This center does the qualifying and re-qualifying of people that registered job-seekers, jobless and those that use the services of career orientation, at every employment office. Professional qualification is based on two objectives: (i) Institutional training in Professional Training Centers and (ii) Combined training (QAP) and company. Professional Training Centers (QAP) offer training for jobless people and job-seekers on a specific profession for free, focusing on the application of practical skills and know-how while using lessons in different cabinets

BONEVET MAKERSPACE BONEVET MAKERSPACE

Qëllimi i qendrës Makerspace është të inkurajojë individë të talentuar me ide për të marrë iniciativa, për të mësuar dhe për të krijuar. Kjo qendër lehtëson procesin e transferimit të teknologjisë në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Rrjedhimisht, forcon bashkëpunimin midis anëtarëve të Makerspace dhe partnerëve të ndryshëm, të cilët mbështesin pjesëmarrjen në projekte të ndryshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

The purpose of Makerspace center is to encourage talented individuals with ideas to take initiatives, to learn and to create. This center facilitates the process of transferring technology to the local and international market, thus strengthening the cooperation between Makerspace members and different associates, who support the participation in different projects in both local and international levels





JAKOVA INOVATION CENTER JAKOVA INNOVATION CENTER

Kjo qendër shërben si inkubator biznesi me një mision të promovimit dhe mbështetjes së sipërmarrësve të rinjë në ndërtimin dhe zhvillimin e kompanive të reja. Pra, misioni i inkubatorit është mbështetja për kompanitë e reja dhe siguri i hapësirave inovative. Gjithashtu ofron këshillime mbështetëse, programe trajnimi në fusha të tilla si: Menaxhimi i Biznesit, Hulumtimi i Tregut, Financimi, Marketingu dhe shumë fusha të tjera të cilat janë të rëndësishme në bërjen e biznesit. Qendra për Inovacion Jakova synon të krijojë një shoqëri kreative, ku të gjithë mund të përcaktojnë në mënyrë të qartë të ardhmen e tyre. Qëllimi kryesor i JIC është të shërbejë si katalizator i kulturës sipërmarrëse midis njerëzve që do të krijojnë dhe zhvillojnë bizneset fillestare në sektorë të interesit të zonës.

This center serves as a business incubator with the mission of promoting and supporting new entrepreneurs in creating and developing new companies. The mission of the incubator is to give support to new ventures through ensuring innovative space. It also offers supportive advice, training programs in fields such as: business management, market research, financing, marketing and many other fields that are vital to creating and maintaining a business. Jakova Innovation Center aims to create a creative society, where everyone can determine their own destiny. The main purpose of JIC is to serve as a catalyst of an entrepreneurship culture that will create and develop ventures in the sectors of interest to the zone.

QENDRA PËR KARRIERË CAREER CENTER

Qendra për Karrierë që funksionon në kuadër të shkollës teknike “Nexhmedin Nixha” është një institucion që ofron shërbime që lidhen me zhvillimin e karrierës së nxënësve. Ekspertët e trajnuar profesionalisht punojnë me nxënësit për të përcaktuar më mirë interesat, mundësitë dhe potencialin e tyre me qëllim që të përcaktojnë fushat më të përshtatshme për zhvillimin e karrierës. Në këtë proces përdoren teknika të ndryshme që përfshijnë sesione individuale, diskutime në grupe dhe trajnime, aplikim të instrumenteve të vlerësimit etj.

Një tjetër aktivitet kryesor i qendrës për karrierë është bashkëpunimi me komunën/bizneset/punëdhënësit. Ajo siguron lidhjen ndërmjet institucionit arsimor dhe biznesit në organizimin dhe realizimin e programeve të praktikës. Punëdhënësit përdorin qendrat për karrierë për të shpallur pozicionet e hapura për praktikantët/punonjësit e rinj.

Career Center which operates in the framework of “Nexhmedin Nixha” technical school, is an institution which offers services associated with developing the careers of the students. Professionally trained experts work closely with students, to better define the interests, opportunities, and the potential of the students with the purpose of defining the most appropriate fields of their career development. In this process, the use different techniques that include individual sessions, group discussions and trainings, application of assessment instruments etc. Another activity of the Career Center is the cooperation with the municipality/businesses/employer. This ensures a bond between the educational institution and the business in organizing and implementing internship programs. Employers use Career Centers to open new job positions for new employers/interns.

